



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin

Mars, 2016

Sindikatat e Arsimit të shteteve të Ballkanit janë takuar në Sofje

Konferencë ballkanike në emër të përkushtimit për paqe



Delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetari Lutfi Mani dhe menaxheri financiar Ymer Ymeri kanë marrë pjesë në Konferencën ballkanike “Sindikatat e Arsimit të Ballkanit për paqe”. Kjo ngjarje është mbajtur në Sofje dhe është organizuar nga Sindikata e Arsimit të Bullgarisë. Në këtë ngjarje të veçantë të sindikatave të arsimit kanë (faqe 6)

Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar me Ministrin Bajrami

Të dy palët të përkushtuara në shërbim të arsimit në Kosovë



Ministri z.Arsim Bajrami bashkë me këshilltarët e tij z.Azem Guri e z.Lah Nitaj ... (faqe 7)

Me një simpozium ndërkombëtar në Tiranë

Kujtohet njeriu i madh me prejardhje shqiptare Mehmet Akif

Marrëveshja e nënshkruar mes sindikatës së madhe turke të arsimit "Egitim-Bir –Sen " me SBASHK-un dhe sindikatat tjera të arsimit nga....(faqe 8)

Intervistë me Fahrije Latifi Retkoceri - drejtoreshë e SHFMU "Shkolla e Gjelbër" Prishtinë

Drejtori duhet të sigurojë klimë bashkëpunuese në shkollë

E lindur në Prishtinë në një familje arsimdashëse. E përkushtuar në punë e me qëllim të arritjeve sa më të ... (faqe 3)

Trajnim me mësimdhënës nga Malisheva e Podujeva

SBASHK-u i përkushtuar për dialogun social



Duke parë se trajnimet për dialogun social kishin zgjuar interesim të madh te anëtarësia gjatë realizimit të projektit ... (faqe 7)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Të kemi guxim qytetar



SBASHK-u falë unitetit dhe përkushtimit të anëtarësisë kudo nëpër Kosovë është bërë një sindikatë që

po gëzon respekt kudo në vend, por edhe në Ballkan e Evropë. Kjo dëshmohet edhe me faktin se gjithnjë e më shumë jemi të ftuar në ngjarje që lidhen me arsimin dhe me aktualitetin. Kjo është mirë dhe duhet ta ruajmë këtë imazh pozitiv me punë e përkushtim dhe me sjelljet dinjitetshme.

Është e qartë se ende ka probleme që duan zgjidhje. Është e qartë se aty e këtu ka edhe shkelje të të drejtave të punëtorëve të arsimit. SBASHK-u ka reaguar dhe ka vepruar që çështjet të zgjidhen. Por, jo me të gjitha rastet e shkeljeve jemi informuar me kohë. Ende po mungon aty e këtu guximi qytetar. Ka raste kur kryetari i shoqatës sindikale të ndonjë shkolle heziton ta ngrit çështjen dhe ajo mbetet e heshtur. Ka raste kur çështje duhet zgjidhur në nivelin komunal dhe kryetari atje në mungesë të guximit qytetar për t'u përballur

me rastin e nis atë drejt e në qendër. Shumë nga çështjet problematike nuk janë për t'u zgjedhur në qendër. Bie fjala dikush ankohet si i janë munguar dy orë. Ky problem ka zgjidhje në shkollë e së largu në DKA.

Ky problem dhe probleme të natyrës së njëjtë duhet shtruar në shkollë dhe në DKA dhe me një përkushtim e me një gjuhë të kulturuar e përmes dialogut edhe gjenden zgjidhje. SBASHK-u po vazhdon me trajnimet për dialogun social dhe duhet dëshmuar se kemi mësuar shumë nga këto trajnime. Këtë duhet ta tregojmë duke dialoguar qetë e me argumente me drejtorin e shkollës, me drejtorin e Drejtorisë Arsimore në komunën tonë e nëse atje dialogu nuk ec si duhet dhe nuk ka rezultate atëherë çështjen e adresojmë drejt selisë së SBASHK-ut në Prishtinë duke sjellë argumente të bollshme. Duhet, pra të kemi guxim qytetar dhe gatishmëri për dialog me gjithë të kulturuar sepse duhet ta ruajmë imazhin e profesionit dhe të SBASHK-ut.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervistë me Fahrije Latifi Retkoceri - drejtoreshë e SHFMU "Shkolla e Gjelbër" Prishtinë

Drejtori duhet të sigurojë klimë bashkëpunuese në shkollë



E lindur në Prishtinë në një familje arsimdashëse. E përkushtuar në punë e me qëllim të arritjeve sa më të mëdha në misionin e shenjtë të arsimit të drejtë të brezave. "Edukimi dhe arsimimi cilësor i nxënësit, është objektivi kryesor i

shkollës. Nëse dëshirojmë të jemi më të mirë, duhet të mësojmë nga më të mirët. Shpresa kryesore e një kombi qëndron në edukimin e drejtë të të rinjve të tij" thotë, veç tjerash, drejtoresha Fahrie Latifi Retkoceri në intervistën për gazetën tonë elektronike .

Arsimimi Sot:

1. Kush është Fahrije Latifi Retkoceri?

Drejtoresha :

✓ij nga Prishtina dhe rrjedh nga një familje arsimdashëse dhe të përkushtuar për shkollën shqipe. Jam bashkëshorte e Gëzimit, mësimdhënëse në SHFMU. "Xhemail Musatafa" Prishtinë, nënë e dy ëmijëve Bledit 18 vjeq (maturant në Gjymnazit shkencor), dhe Eronës 15 vjeq (nxënëse e Gjymnazit shkencor).

✓etoj në Prishtinë, në lagjen Lakrishtë, ku bëj një jetë normale dhe të lumtur me familje.

✓shkollimin fillor dhe të mesëm kam kryer në shkollat e pyetit të Prishtinës, studimet i kam përfunduar në Fakultetin Filozofik, drejtimi histori po ashtu edhe studimet Master në Fakultetin e Edukimit pranë UP "Hasan Prishtina", drejtimi Udhëheqja në Arsim.

✓vlen të theksohet se për herë të parë kam filluar punën si mësimdhënëse e historisë në fshatin Lupç të Poshtëm në SHFMU. "Zenel Hajdini" deri në vitin 2002. Në vitin 2002 u zgjodha drejtoreshë në të njëjtën shkollë, ku rezultatet nuk kanë munguar, kishte sfida po krahas sfidave ishin edhe rezultatet, këtë letyrë e vazhdoja deri më 2010. Nga viti 2010 jam ristemuar në Prishtinë, si zv. drejtoreshë në shkollën "Shkëndija" Hajvali" për 1 vit.

Dhe nga viti 2011 përcaktohem UD drejtori në SHFMU. " Shkollën e Gjelbër" në Prishtinë , meqë shkolla ishte në themelim e sipër , ku në vitin 2012 u zgjodha Drejtoreshë e "Shkollës Gjelbër".

Arsimimi Sot:

2. Cili është roli i drejtorit në shkollë në shërbim të arritjeve sa më të mëdha?

Drejtoresha :

Drejtori për dallim nga e kaluara tani është më i hapur, ai mund të mbaj lidhje me organizata qeveritare dhe joqeveritare me biznese afariste gjithmonë për të plotësuar interesat e shkollës. Ajo që vlen të përmendet është edhe marrëdhënia e drejtorit me prindërit, ku prindërit janë aleatët kryesor që mund të kontribuojnë në mbarëvajtjen e procesit arsimor në shkolla. Koordinon lidhjet me personelin e shkollës. Drejtori duhet të sigurojë klimë bashkëpunuese në shkollë me qëllim që të mundësoj avancim në zhvillimin e shkollës dhe në arritjet profesionale të mësuesve dhe të nxënësve. Drejtori është përgjegjës për përmirësimin e mirëqenies së mësuesve dhe personelit tjetër dhe duhet të sigurojë se kushtet e punës të jenë me kualitet të lartë të punës. Ai duhet të sigurojë që personeli të kenë terma dhe kushte të qarta të punës dhe se të gjitha marrëveshjet dhe rregulloret mbi pagën, orët dhe kushtet e punës të ndiqen. Marrëdhëniet me nxënës është funksion i një fushe jo vetëm të ndjeshme por edhe qendrore të shkollës. Drejtori është në kontakt të përhershëm me nxënësit. Edukimi dhe arsimimi cilësor i nxënësit, është objektivi kryesor i shkollës. Ai duhet të ofroj kushte që të gjithë nxënësit të gëzojnë të drejtat për shkollim përmes kurikulumit shtetëror, shkollimi që ofrohet të jetë i përshtatshëm për moshën dhe aftësitë e çdo nxënësi si dhe të përmbush nevojat udhëzuese të të gjithë nxënësve.

Arsimimi sot :

3. Shkolla juaj përmendet për të mirë, cilat nga arritjet do të veçonit?

Drejtoresha :

“Shkolla e Gjelbër” gjendet në pjesën verilindore të Prishtinës. Është një shkollë e vetme në Ballkan për nga ndërtimi dhe do të jetë shembull edhe për shkollat tjera si për nga ndërtimi ashtu edhe nga aspekti i cilësisë në mësim. Në ndërtimin e kësaj shkolle kontribuan Komuna e Prishtinës dhe USAID. Shkolla është ndërtuar në vitin 2009-2010 dhe punën e ka filluar më 1 mars 2011.

Aspektet unike të shkollës sonë janë: ngrohja dhe ftohja gjeotermale, panelet solare, kursimi i ujit, fasada termike prej druri dhe një kulm i gjelbër, i cili njëkohësisht shërben si izolator dhe kultivim të bimëve. Kjo shkollë mundëson që nxënësit të mësojnë në një mjedis të shëndetshëm, gjë që ndikon në përmirësimin e cilësisë së mësimi dhe zhvillimit në përgjithësi.

Arritjet për 5 vite punë në shkollën tonë janë të shumta duke falënderuar bashkëpunimin e mirëfilltë që kemi, në trekëndëshin e shkollës Drejtor-mësimdhënë-nxënës pastaj trekëndëshi Shkollë, prind, DKA, si dhe me MASHT, SBASHK etj. Nga kjo kemi arritur :

- 1) Sigurimin e një infrastrukture shkollore moderne
- 2) Plotësimin me bazë materiale të pajisjeve nga më cilësoret
- 3) Punën me përkushtim e profesionalizëm të lartë të stafit arsimor që realizojnë një mësimdhënie bashkëkohore.
- 4) Organizimin e procesit mësimor me synim që t’u përgjigjet maksimalisht kërkesave të prindërve, prirjeve e interesave të nxënësve.

Këto janë vetëm disa nga të arriturat që kemi si shkolle, pasi janë të shumta, edhe çdoherë mbetet për t’u dëshiruar, pasi nxënësi është Ai që çdoherë kërkon inovacione , andaj duhet ecur me kohën!

Arsimimi sot:

4. Si e shihni angazhimin sindikal në shkollën tuaj?

Drejtoresha :

Angazhimi sindikal në shkollën tonë është në nivelin e duhur, ku arrijnë bashkëpunim të mirëfilltë kolegjial, profesional etj. Gjithë anëtarësia sindikale e shkollës sonë ku edhe une jam pjesë e antarësisë, janë të kënaqur, në rend të parë përkrahja nga SBASHK, pastaj mbajnë takime dhe konsulta për trajnime që organizon ky institucion. Kemi mësimdhënës që janë trajnuar nga ky institucion, pastaj janë bërë vizita të ndryshme ku prap kanë qenë pjesëmarrës edhe disa mësimdhënës tanë. Krahës kësaj kemi pasur nderin të vizitohemi nga kryesindikalistët e SBASHK-ut, si dhe sekretarit gjeneral të Internacionales Botërore të Arsimit. Thënë të drejtën SBASHK është e dosidoshëm ekzistimi i saj pasi që përveç që mbron interesat e punëtorëve nëpër shkolla, tani më organizon trajnime të ndryshme që ka të bëjë me ngritjen e cilësisë.

Arsimimi sot:

5. Çmoheni si drejtoreshë e suksesshme, si e arrini këtë?

Drejtoresha:

Ju falënderoj për vlerësimin, thënë të drejtën nganjëherë mendoj që ende nuk jam kah e japi atë që duhet! Puna si udhëheqës e institucionit shkolllor, me flenë në shpirt dhe e kryej me plot zëmër dhe përkushtim. Jam e lidhur shumë me staf arsimor e me nxënës sidomos, kjo mund të jetë edhe trashëgimia familjare, përvoja, punësimi qysh në moshën e re e kjo e bën që këtë detyrë që më është besuar e respektoj dhe e çmoj.

Shpesh e kam në mendje se nëse dëshirojmë të jemi më të mirë, duhet të mësojmë nga më të mirët. Njerëzit e suksesshëm duhet shpesh të shohin nga njerëz të tjerë të suksesshëm si mjet për motivimin e vetes .

Ajo që kam arritur deri më tani është në rend të parë përkrahja e familjes, e sidomos bashkëshortit, por më e vërteta është se kam besim në vete për punën që e bëj , punë kjo në shkolla e që e çmoj shumë.

“Së pari zgjoj në të afërmin, dëshirën për veprim. Nëse këtë e arrin, e gjithë bota do të jetë pranë teje, nëse jo – do të mbeten vetëm.” Dale Carnegie
Andaj fillimisht kam ndjekur mjaft trajnime për udhëheqje, pastaj edhe studimet master, pastaj përvoja e punës, që më kanë ndihmuar shumë, që të jem

ndikuese, e ndershme, te punoj me prioritete, të jem inovatore, te ndihmoj ne zgjedhje të problemeve, qëndrim të drejtë dhe barabartë me ambicie pozitive, vizionare, çdo herë e gatshme për ngritje profesionale për staf arsimor, këmbëngulëse ne zbatimin e normave pedagogjike, morale, e ligjore, e në fund llogaris vetën nxënës tërë jetën. E këto veçori të mia, po barten edhe tek stafi mësimdhënës, nxënës dhe rezultatet nuk po mungojnë.

“Shpresa kryesore e një kombi qëndron në edukimin e drejtë të të rinjve të tij “

Arsimimi sot:

6. A keni ndonjë këshillë apo porosi për SBASHK-un ?

Drejtoresha:

Si këshillë do ta kisha dhënë për SBASHK-un, që të jep mundësi moshës së re inkuadrim sa më të madh në vendimmarrje dhe bashkëpunim, porosia ime është që të organizohen sa më shumë trajnime për mësimdhënës po edhe staf udhëheqës, që të ndihmohet ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, njëkohësisht uroj që sukseset të mos i mungojnë dhe të jenë gjithmonë krah i punëtorëve.

Arsimimi sot:

7. A e ka gjetur ende femra vetën në pozita vendimmarrëse?

Drejtoresha:

Sipas mendimit tim, femra është e përfaqësuar në pozita vendimmarrëse, por dua të shtoj që duhet edhe më shumë përfaqësim. Ajo që dua të ceku është se femra fillimisht duhet të ketë vetëbesim në punën që i besohet. Thënë të drejtën nuk i kam në qejf kuotat,

vetëm pse është femër të iu japin vende dhe pozita, por vlerësimi duhet të jetë i njëjtë në bazë të kapaciteteve dhe zhvillimit profesional që ka. Një përfaqësim i denjë i femrës është shumë e rëndësishme, e jo përfaqësim sa për sy e faqe, vetëm pse është femër duke mos e kryer dhe mos pasur kapacitet për punën që e bën!

Andaj roli i femrës në shoqëri është shumë i domosdoshëm dhe i nevojshëm. Sa më shumë femra të emancipuara dhe me vetëbesim të plotë, shoqëria kosovare do të ec përpara, ku nuk mungon tani edhe pjesëmarrja e duhur në vendimmarrje.

Barazia gjinore është më tepër se një qëllim i vetëm. Është parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për qeverisjen e mirë. Dhe pikërisht për të arritur këtë qeverisje të mirë, këtë zhvillim të qëndrueshëm, shihet se aktivizimi i femrave është i domosdoshëm. Ai ndikon drejtpërdrejtë në sigurinë juridike e madje edhe fizike të qytetarëve tanë. Por fatkeqësisht, femrat hasin edhe në një problem shtesë të sigurisë. Një femër e emancipuar edhe shoqëria është e emancipuar!

Arsimimi sot :

8. A keni diçka për të shtuar ?

Drejtoresha:

Ju falënderoj, për përzgjedhjen që më keni bërë që të jam pjesë e kësaj interviste në revistën që e botoni, uroj që Arsimi shqiptar të arrin cilësinë e duhur. Gjithsecili dëshiron t'i shoh njerëzit e mëdhenj, por më mirë është të shohësh veprat e tyre, d.m.th. të shohësh ata vetë, sepse idetë e tyre nuk kuptohen nga fytyrat e tyre , por dallohen nga veprat e tyre. Ju uroj punë të mbarë dhe suksese!

Gjatë muajit

Sindikatat e Arsimit të shteteve të Ballkanit janë takuar në Sofje

Konferencë ballkanike në emër të përkushtimit për paqe

Delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetari Lutfi Mani dhe menaxheri financiar Ymer Ymeri kanë marrë pjesë në Konferencën ballkanike "Sindikatat e Arsimit të Ballkanit për paqe". Kjo ngjarje është mbajtur në Sofje dhe është organizuar nga Sindikata e Arsimit të Bullgarisë. Në këtë ngjarje të veçantë të sindikatave të arsimit kanë marrë pjesë edhe nënkryetarja e shtetit të Bullgarisë, znj. Margarita Popova, Zv/kryeministre dhe Ministre arsimit të Bullgarisë, znj. Meglena Kuneva, drejtori ekzekutiv i Komitetit të Sindikatave Evropiane të Arsimit, z. Martin Romer dhe personalitete të tjera.

Duke hapur këtë Konferencë, kryetarja e Sindikatave të Arsimit të Bullgarisë, znj. Janka Takeva ka përshëndetur pjesëmarrësit e Konferencës e pastaj ka deklaruar se ngjarjet e fundit tronditëse në Paris, Bruksel e Stamboll alarmojnë se ne duhet të angazhohemi me tërë mundësitë në emër të paqes kudo jemi.

Nënkryetarja e shtetit të Bullgarisë, znj. Margarita Popova, dhe Zv/kryeministri dhe Ministre e Arsimit të Bullgarisë, znj. Meglena Kuneva po ashtu kanë përshëndetur Konferencën dhe janë ndalur në momentin aktual duke apeluar të gjithë mësimdhënësit sindikalistë në Ballkan, Evropë e botë që të promovojnë vlerat humane dhe të edukojnë brezat në frymën e paqes dhe tolerancës. Kishte ardhur në Sofje edhe Drejtori ekzekutiv i Komitetit të Sindikatave Evropiane të Arsimit, z. Martin Romer. Ai ka përgëzuar kryetaren e Sindikatës së Arsimit të Bullgarisë, zonjën Takeva për organizimin e mirë të kësaj ngjarje të rëndësishme e pastaj u është drejtuar pjesëmarrësve me apelin që në këto kohë të trazura të angazhohen me gjithë qenien në merr të paqes dhe solidaritetit kudo janë.



Në paraqitjen e tij kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka falënderuar zonjën Takeva dhe sindikalistët e arsimit të Bullgarisë për organizimin e këtij takimi duke e konsideruar Konferencën si një përpjekje të sigurtë për paqe dhe solidaritet. Jasharaj pasi ka dhënë një pasqyrë të aktiviteteve të SBASHK-ut lidhur me temën e Konferencës ka thënë se: "Anëtarët e SBASHK-ut, por edhe institucionet e shtetit dhe shoqëria civile në Kosovë kanë dhënë kontribut në emër të paqes dhe lirisë për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë. Ne në decenien e fundit të shekullit të kaluar në lëkurën tonë e kemi përjetuar se si është të jetohet pa liri, pa paqe e pa buzëqeshjen në fytyrat e fëmijëve. Ne populli shumicë në Kosovë kurrë nuk do të lejojmë që të tjerëve t'u ngjajë ajo që na ka ndodhur neve në ato vite plot burgosje, vrasje e mohim të lirive elementare nga pushtuesi", është shprehur para pjesëmarrësve të Konferencës, kryetari i SBASHK-ut.

Në kuadër të punimeve të Konferencës është bashkëbiseduar edhe për gjendjen në arsim në vendet e Ballkanit. Pjesëmarrësit janë pajtuar se në shtetet e tyre ende duhet bërë shumë në përkrahje të arsimit dhe në përpjekjet për një arsim më cilësor dhe se në këtë angazhim nuk duhet lënë vetëm mësimdhënësin. Në takimin përshëndetës delegacionet pjesëmarrëse janë pajtuar që me takime të tilla të vazhdohet edhe në të ardhmen me qëllim që të forcohet bashkëpunimi dhe solidariteti mes sindikatave të arsimit, por edhe mes popujve të Ballkanit.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar me Ministrin Bajrami

Të dy palët të përkushtuara në shërbim të arsimit në Kosovë

Ministri z.Arsim Bajrami bashkë me këshilltarët e tij z.Azem Guri e z.Lah Nitaj ka pritur në kabinetin e tij kryetarin SBASHK-ut, z.Rahman Jasharaj dhe menaxherin për financa e këshilltarin për organizim të brendshëm, z.Ymer Ymeri. Në fillim të këtij takimi delegacioni i SBASHK-ut ka përgëzuar në emër të gjithë të punësuarve në arsim Ministrin Bajrami për promovimin e tij anëtar në Akademinë Evropiane të Shkencave dhe Arteve në Salzburg të Austrisë. Ministri Bajrami dhe kabineti i tij kanë përgëzuar SBASHK-un për ceremoninë festive me të pensionuarit në arsim me rastin e 7 Marsit. Ky aktivitet është vlerësuar lartë nga opinioni dhe nga MASHT



Pas kësaj delegacioni i SBASHK-ut ka informuar Ministrin Bajrami dhe kabinetin e tij për çështjet dhe preokupimet aktuale në Arsimin Parauniversitar dhe në Universitet. Ata janë ndalur të kurikuli i ri për shkollat profesionale dhe të shqetësimi i mësimdhënësve të lëndëve shoqërore se çfarë mund të ndodh me normat e tyre të punës.

Ministri Bajrami ka përsëritur qëndrimin e MASHT-it se kurikuli në shkollat profesionale, por edhe në arsim

në përgjithësi nuk do të krijojë probleme për të punësuarit në arsim sepse do të bëhet gjithë e mundura për të ruajtur vendet e punës për gjithë të punësuarit, edhe pse siç u tha, ka rënie të vazhdueshme të numrit të nxënësve. Delegacioni i SBASHK-ut përmendi edhe faktin se në muajt janar e shkurt nuk është bërë shtimi në paga edhe për një vit të përvojës së punës. Është konstatuar se kjo ka mundur të ndodh për ndonjë arsye teknike dhe se kjo çështje do të gjejë zgjidhje.

Delegacioni i SBASHK-ut në këtë takim ka bashkëbiseduar me Ministrin Bajrami edhe për shkollat shqipe në veri të Kosovës për të cilat është thënë se duhet të kenë kujdes të shtuar nga institucionet tona. Të dy palët janë pajtuar që një delegacion i përbashkët të vizitojë këto shkolla për të parë nga afër situatën aktuale dhe për të dëgjuar për hallet dhe idetë e mësimdhënësve atje. Është biseduar edhe për rastet kur një numër të punësuarish në arsim punojnë e nuk marrin paga. Është thënë se do të ketë angazhime në ato komuna që kjo çështje të tejkalohet. Delegacioni i SBASHK-ut ka shtuar në këtë takim edhe shqetësimin për rastet kur mësimdhënësit e sëmurë rënd detyrohen të shkojnë në mësim pa pasur ndonjë zgjidhje tjetër. SBASHK-u ka përmendur idenë që në komuna të formohen ekipe të personelit të diplomuar të cilët pastaj do të angazhoheshin për të zëvendësuar vullnetarisht mësimdhënësit e sëmurë dhe se këtyre do t'u njihej ky angazhim si përvojë e punës, që do t'u jepte përparësi me rastin e punësimit në sistemin arsimor.

Trajnim me mësimdhënës nga Malisheva e Podujeva

SBASHK-u i përkushtuar për dialogun social

Duke parë se trajnimet për dialogun social kishin zgjuar interesim të madh të anëtarësia gjatë realizimit të projektit të përbashkët KEC- SBASHK, që ishte mbështetur nga Komisioni Evropian, zyra e BE në Prishtinë, Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka vendosur që të vazhdohet me këtë aktivitet përmes trajnimeve me mësimdhënës nga komunat që nuk ishin përfshirë më parë në këtë lloj trajnimi.

Në vazhden e këtij aktiviteti në Durrës këtë muaj është mbajtur seminari 3 ditor me temën "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut

social". Në këtë aktivitet sindikal pjesëmarrës ishin punëtorë të arsimit nga Malisheva dhe Podujeva. Punimet e këtij trajnimi kanë nisur me fjalën



përshëndetëse të kryetarit të SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj i cili është shprehur i bindur se pjesëmarrësit e këtij aktiviteti njohuritë e fituara këtu do t'i prezantojnë para kolegëve të tyre në shkollat e Malishevës e Podujevës. Ai pastaj ka folur për angazhimet, arritjet dhe sfidat e SBASHK-ut duke apeluar që të vazhdohet me përkushtimin në punë dhe me forcimin e vazhdueshëm të SBASHK-ut.



Ai është ndalur edhe të rëndësia e përgatitjes së

kuadrove për dialogun social.

Kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM të Malishevës e Podujevës, z. Elez Krasniqi e z.Fadil Halimi në emër të anëtarësisë nga këto dy komuna kanë lavdëruar SBASHK-un për angazhimet, arritjet dhe për këtë aktivitet të rëndësishëm . Ata ajnë shprehur të sigurt se njohuritë e fituara në këtë trajnim do të përcillen kudo në shkollat e këtyre dy komunave.

Pas kësaj është filluar me trajnimin dhe trajneri i licencuar Ymer Ymeri ka nisur të shpalos temat konkrete duke bërë hyrjen ën dialogun social e për të vazhduar me "dialogu social në kontestin kombëtar". Ai në bashkëbisedë me pjesëmarrësit e trajnimit janë ndalur edhe të sfidat lidhur me dialogun social, si zhvillohet dialogu social, kujdesi që duhet të kemi gjatë gjithë kohës në dialogun social dhe me çështje të tjera. Ky trajnim ka zgjuar interesim te pjesëmarrësit, të cilët janë të angazhuar dhe bashkërisht po debatojnë për çështjet duke dhënë edhe ide interesante.

Me një simpozium ndërkombëtar në Tiranë

Kujtohet njeriu i madh me prejardhje shqiptare Mehmet Akif



Marrëveshja e nënshkruar mes sindikatës së madhe turke të arsimit "Egitim-Bir –Sen " me SBASHK-un dhe sindikatat tjera të arsimit nga Shqipëria dhe shtete të Ballkanit ka sjellë angazhimin e parë të përbashkët. Në Tiranë është mbajtur Simpoziumi Ndërkombëtar "Mehmet Akif Ersoj në vendlindje".Kjo ngjarje kulturore kushtuar autorit të himnit turk me prejardhje shqiptare ka zgjuar interesim të madh në kryeqytetin shqiptar. Kanë ligjëruar 21 ekspertë Turqia, Shqipëria , Kosova e Maqedonia në temat "Periudha dhe jeta e Mehmet Akif Ersoj", "Mehmet Akifi dhe rajoni i Ballkanit" "Mendimet e civilizimit dhe idetë botërore të Mehmet Akifit", "Poezia, arti dhe estetika e Mehmet Akifit dhe "Arsimi, rinia dhe modernizimi i Mehmet Akif Ersoj" janë pesë sesionet e këtij simpoziumi në të cilin janë duke ligjëruar 21 ekspertë nga e që janë njohës të mirë të jetës dhe

veprës së Mehmet Akif Ersojit.

Këtë ngjarje kulturore e kanë nderuar me pjesëmarrjen dhe paraqitjet e tyre edhe Ministri turk i arsimit, z.Nabi Avci , nënkryetari në Parlamentin e Shqipërisë, z. Shpëtim Idrizi.



Edhe ministri Turk i arsimit po edhe gjithë ligjëruesit duke folur për jetën dhe veprën e Mehmet Akif Ersojit e kanë deklaruar se ai gjithmonë e kishte thënë publikisht se ndjehet krenar me përkatësinë e tij kombëtare shqiptare dhe se shpesh përmes poezive kishte shpreh mallin dhe dhembjen për vendlindjen e prindërve të tij, për fshatin Shushicë në komunën e Istogut.

Kryetari i Sindikatës turke të arsimit "Egitim-Bir-Sen" , Ali Yalçın në fjalën përshëndetëse ka kujtuar për marrëveshjen e bashkëpunimit mes sindikatës që ai drejton dhe SBASHK-un , Sindikatës shqiptare të arsimit SPASH, Sindikatës maqedone të arsimit dhe sindikatave tjera në Ballkan.

Me interes për jetën dhe veprën e Mehmet Akif Ersojit ishin edhe prezantimet e: Prof.dr. Milazim Krasniqi , z.Necmettin Turinay, z.Nuredin Ahmeti, z.Yusuf Kaplan, z.Mevlut Dudiq, z.Zyhdi Dervishi, z.Musa Kraja, z.Hasan Akay, z.Hysen Matoshi e shumë të tjerë.



Letër e Sekretarit të përgjithshëm z. Fred van Leeuwen EI falënderon SBASHK-un për mesazhin e solidaritetit

"Lajmi i sotëm për sulmet terroriste që ndodhen sot në Bruksel është lajm tronditës për mësimdhënësit, por edhe për gjithë popullin e Kosovës", thuhet në ngushëllimin e SBASHK-ut drejtuar selisë së EI-së në Bruksel pas ngjarjeve tragjike në këtë qytet. SBASHK-u ka dërguar telegrame ngushëllimi dhe mesazh solidariteti edhe në selitë e EI, ETUCE dhe sindikatave të arsimit në Belgjikë : COC, ACOD-CCSP, ACVOD-CSCSP, CGSP-FGTB dhe COV.

Në përgjigjen e ardhur nga Sekretari i Përgjithshëm i Internacionales Botërore të Arsimit, z.Fred van Leeuwen. veç tjerash thuhet:
....Ne dëshirojmë të ju falënderojmë për mesazhet tuaja të solidaritetit, të cilat kanë përcjellë, jo vetëm shqetësimin tuaj shumë të vlerësuar në lidhje me sigurinë e kolegëve tuaj të EI-së, por edhe vendosmërinë tuaj se ne qëndrojmë së bashku pa frikë për të parandaluar ekstremistët nga tendencat për të goditur vlerat dhe liritë tona demokratike.

Përtëritet Marrëveshja me Spitalin "Istanbul Medicine" Një kontroll i përgjithshëm i zemrës falas, zbritje çmimesh për shërbimet

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj bashkë me menaxherin për financa, Ymer Ymeri e zyrtaren Vlora Rexhepi-Berisha kanë zhvilluar në ambientet e Spitalit të Përgjithshëm "Istanbul Medicine" një takim me drejtorin e përgjithshëm të këtij institucioni shëndetësor, z. Ali Hocaoglu dhe stafin e tij. Ata kanë biseduar për efektet e marrëveshjes së nënshkruar një vit më parë në shërbim të anëtarësisë dhe duke lavdëruar korrektësinë e ndërsjellë kanë nënshkruar kontratën për zbritje çmimesh për vitin 2016. Të dy palët duke uruar që asnjë nga anëtarët e SBASHK-ut të mos ketë nevojë për shërbime në këtë spital janë shprehur të gatshëm për bashkëpunim korrekt në shërbim të anëtarësisë në shenjë respekti për punën e madhe që mësimdhënësit kanë bërë e po bëjnë në arsimimin e brezave.



Ky institucion shëndetësor për gjithë anëtarët e SBASHK-ut dhe familjarët e tyre ofron zbritje prej 20 % për çdo shërbim të ofruar. E veçanta e kësaj marrëveshjeje është se Spitali i Përgjithshëm "Istanbul Medicine" për gjithë anëtarët e SBASHK-ut do të kryej kontroll falas të zemrës një herë në vit.